



Fakte mbi KAEF

Qëllimi

Qëllimi i programit të **Fondit Kosovaro Amerikan për Edukim (KAEF)** është përkrahja afatëgjate e zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke u mundësuar kosovarëve të talentuar bursa për top-trajtime në universitetet elite të SHBA-ve. Me t'u kthyer në Kosovë, të diplomuarit e këtij programi i synojnë pozitat e udhëheqësisë në biznese, organizata jo-fitimprurëse dhe qeveri, dhe i përdorin njohuritë e tyre teknike në mënyrë që të gjenerojnë ndryshim të qendrueshëm dhe pozitiv në vend.

I krijuar nga populli amerikan nëpërmjet Agjencionit të SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe i administruar nga Këshilli Amerikan për Edukim Ndërkombëtar, programi KAEF është fond i vazhdueshëm i edukimit i cili u mundëson kosovarëve të kualifikuar (me të drejtë aplikimi) mundësinë e ngritjes së njohurive dhe aftësive në fushat që e përkrahin zhvillimin ekonomik dhe investimet në Kosovë.

Që nga viti 2004 deri në fund të vitit 2009, programi KAEF ka ndarë 39 bursa për nivelin master, bazuar në një proces garues në baza meritore. Deri më tani, tre grupe të të diplomuarve janë kthyer në Kosovë, dhe kanë marrë pozita udhëheqësie në sektorin publik dhe atë privat.

Origjina

Pak pas vendosjes së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 1999, USAID krijoi Fondin e Financave të Biznesit Kosovar (KBFF) për ta avancuar ngritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ky fond është përdorur për krijimin e Bankës Amerikane të Kosovës, bankë komerciale kjo e cila për vite me radhë ngriti një portfolio të kredive si dhe një nivel të konsiderueshëm të depozitave. Shitja e këtyre asetëve/vlerave mundësoi krijimin e Fondit Kosovaro Amerikan për Edukim - KAEF. Në garë të hapur, Këshilli Amerikan për Edukim Ndërkombëtar është shpërblyer me administrimin e fondit, në prill të vitit 2004.

Me fjalët e tyre

Luan Dalipi

Monterey Institute of
International Studies



“Kosova ka nevojë për vazhdimësi suksesesh biznesi për t'i ikur një herë e përgjithmonë imazhit të vendit të pas-lufte me mundësi të kufizuara për investime. Kosovarët që posedojnë nivelin e masterit në administrim të biznesit në të ardhmen e afërt do të jenë Ambasadorët e Biznesit Kosovar për pjesën tjetër të botës. Nëpërmjet investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, Kosova do ta sigurojë stabilitetin ekonomik, dhe me stabilitetin ekonomik stabiliteti politik do të forcohet.”

Edona Pacarada

George Washington
University



“Kthimi në Kosovë dhe të qenit pjesë e ekipit që i është besuar misioni i promovimit të zhvillimit të ekonomisë së qëndrueshme kërkon kuptueshmëri të gjërë të çështjeve të biznesit dhe faktorëve të tjerë të përfshirë në proces - shoqëror, politik dhe ndërkombëtar. Unë fuqimisht besoj se programet e ofruara nga universitetet e nivelit të lartë, nëpërmjet programit të KAEF-it, do të më sigurojnë mua me pasqyrën teorike dhe aftësitë praktike, të nevojshme për të sjellur kontribut të dukshëm në ambientin e biznesit kosovar.”

Dastid Pallaska

Yale University



“Rritja në një dekadë ndryshimesh dhe trazirash konstante me ka bërë që ta kuptoj rëndësinë e udhëheqësisë së mirë dhe të pasojave që vijnë në mungesë të saj. Kjo situatë, në fakt, ishte ajo që ndikoi në vendimin tim që të mos qëndroj me përtaci pranë proceseve që ndikojnë në të ardhmen e shoqërisë sime, por të merrem me to proaktivisht.”

Suksesi akademik

- Deri më tani, tridhjetë e nëntë kosovarë janë fitues të bursës së KAEF-it
- Bursistët ndjekin mësimet në universitetet më prestigjioze të SHBA-ve si Columbia, Johns Hopkins, Duke dhe Yale. Pjesa më e madhe ka studiuar Administrimin e Biznesit apo Ekonominë, por një numër i madh ka studiuar edhe në fusha si Drejtësi, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Administrim Taksash, dhe Gazetari e Komunikim në Masë.
- Pa përjashtime, bursistët kanë performuar jashtëzakonisht akademikisht. Bursistët e KAEF-it kanë fituar reputacion si shumë-punëtor, kreativ, të zellshëm dhe studentë të shoqërueshëm.

Përvoja Praktike

Bursistët e KAEF-it fi tojnë mundësinë për përvoja të vlefshme, duke përfshirë:

- **Internship-et verore** - Bursistët e KAEF-it janë të detyruar të kryejnë stazhin e punës në fushat e tyre përkatëse në biznese apo organizata gjatë muajve të verës.
- **Trajnime të praktikës** - Bursistëve të KAEF-it u jepet mundësia e qëndrimit në SHBA edhe gjashtë muaj pas përfundimit të nivelit të tyre në mënyrë që të marrin pjesë në internship-e të trajnimit praktik.
- Bursistët e KAEF-it kanë shërbyer me: Kompjuterët Dell, Bankën Botërore, Zërin e Amerikës, Korporatën Ndërkombëtare të Financave, Qendrën e Duke-ut për Zhvillime Ndërkombëtare dhe Korporatën Xerox.

Mundësitë për të fituar përvojë të vlefshme i japin mundësi miqëve të KAEF-it që t'i testojnë dhe përpunojnë njohuritë akademike të tyre, të mësojnë nga liderët e industrisë, dhe të lidhen me profesionistë që punojnë në fushat e tyre të ekspertizës. Rezultati është se miqtë e KAEF-it jo vetëm që kryejnë program me edukim të avancuar teorik, por gjithashtu njihen edhe me mënyrën e aplikimit të kësaj teorie në ambientet e botës reale.

Me fjalët e tyre

Diell Bakalli

Monterey Institute of
International Studies



“Profesionistët frymëzues të biznesit dhe menaxherët e ardhshëm duhet të marrin trajnim të duhur dhe të grumbullojnë përvojë në ambient të shëndoshë, njëkohsisht sfidues.”

Teuta Kacaniku

Tufts University



“Me të pasur (statusin e pamvarur të njohur ndërkombëtarisht), Kosova do të ketë nevojë për profesionistë që do ta udhëzojnë procesin e saj të integritimit në tregun global. Ky është procesi ku unë e shoh vehten të inkuadruar në të ardhmen.”

Besa Luci

University of Missouri
at Columbia



“Në botën e sotme të ndërlidhur në rritje, gazetaria është fushë e fuqishme, e cila jo vetëm i jep formë ngjarjeve globale, por gjithashtu jetërave të përditshme të njerëzve. Qëllimi im është ti vë në praktikë, si gazetare profesionale në Kosovë, njohuritë e mija në nivelin e shkallëzimit.”

Në mënyrë që KAEF të jetë sa më i suksesshëm, KAEF ka nevojë që t'i identifikoj dhe përzgjedh, kandidatët më të talentuar për bursë. Për këtë arsye, KAEF shpenzon energji të madhe në administrimin e një procesi të selektimit gjithpërfshirës, të hapur dhe të drejtë për bursat në fjalë. Pesë vite pas krijimit të KAEF-it, me krenari themi se procesi ynë i selektimit është prej proceseve më të barabarta dhe më transparente që ekzistojnë.

Kandidatët perzgjidhen pa marrë parasysh etninë e tyre, besimin fetar, lidhshmëritë politike, lidhjet familjare apo burimet financiare. Kriteret e selektimit të KAEF-it janë të thjeshta: a kanë kandidatët talent, dijeni, dëshirë dhe përkushtim ta ndihmojnë zhvillimin e Kosovës?

Proçesi i aplikimit

KAEF-i identifikon Kosovar të talentuar, motivuar si potencial për bursë nëpërmjet një konkurrence të hapur, të bazuar në meritë që shtrihet në çdo shtresë të shoqërisë kosovare:

1. Kandidatët aplikojnë nëpërmjet formës së regjistrimit on-line.
2. Në muajt para Shtatorit, kur përfundon afati i aplikimit, stafi i programit e bën reklamimin e programit të KAEF-it nëpërmjet shtypit, radios, televizorit dhe internetit.
3. KAEF-i përdor lidhjet e tij me Zyren Amreikane në Prishtinë, Universitetin e Prishtinës, dhe universitetet private, si dhe bizneset private për të mbajtur seanca informative mbi program me studentë dhe profesionistë që mendojnë të aplikojnë.

Proçesi i selektimit

Me të pranuar aplikacionet, KAEF-i e inicon procesin rigoroz dhe transparent të selektimit:

1. Në Tetor, aplikacionet lexohen dhe vlerësohen nga këshilli me përfaqësues nga departamentet pranuese të institucioneve të edukimit të lartë të SHBA-ve.
2. Përafërsisht një e treta e kandidatëve që aplikojnë bëhen semi-finalistë.
3. Në Dhjetor, menaxherët e programit të KAEF-it fluturojnë për në Kosovë së bashku me stafin pranues nga dy institucione partnere për t'i intervistuar secilin nga semi-finalistët.
4. KAEF-i paguan për semi-finalistët, testet e standardizuara (TOEFL dhe njërën nga GMAT apo GRE) ndërmjet Janarit dhe Shkurtit.
5. Më ti marrë rezultatet e testeve, paneli i fundit selektues i përbërë nga stafi i Këshillit Amerikan dhe nënpunësit nga universitetet e SHBA-ve shqyrtojnë dhe selektojnë finalistët dhe kandidatët alternativë.
6. Finalistët njoftohen për statusin e tyre në Prill.

Me rëndësi është të theksohet se të gjitha vendimet mbi selektimin behën nga një panel anonim, i paanshëm, i përbërë nga stafi i universiteteve për pranim të studentëve, e gjithë perzgjedhja bëhet në SHBA për të garantuar se procesi nuk ka ndërhyrje të jashtme. As stafi i KAEF-it nuk ka mundësi që të ndërhyjë në vendimin e komisionit perzgjedhes.

kaef

Partnerët që kanë ndikuar ne suksesin e KAEF-it

Përkrahja private

Megjithë që pjesa më e madhe e KAEF-it mbështetet prej interesit të fondit KAEF. Bursa gjithashtu varet nga mbështetja bëmirese e bizneseve, individëve dhe organizatave. Pa kontributet bamirëse të tyre, KAEF nuk do të ishte i mundur.



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU S.H.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENSA I TRZISTA. A.D.



Këshilli Amerikan

Këshilli Amerikan për Edukim Ndërkombëtar është krenar ta administroj programin KAEF. Këshilli Amerikan është një organizatë jo profitabile me përvojë mbi tridhjetë vjeçare në administrimin e programeve shkëmbimore edukative të nivelit master, ndërmjet SHBA-ve dhe shteteve të Euroazisë. Ne besojmë se duke investuar tek njerëzit e jashtëzakonshëm dhe 'udhëtimet' e tyre edukative, ne mund të krijojmë zhvillim afatgjatë, të qëndrueshëm tek shoqëritë përreth botës.

Universitetet pjesëmarrëse

Nga fillimi i programit deri në ditën e sotme, universitetet e cekura më poshtë i kanë pranuar bursistët e KAEF-it: Bowling Green State University, Cleveland State, The College of William & Mary, Columbia University, Duke University, George Washington University, Harvard University, Indiana University, Johns Hopkins University, The University of Minnesota, The Monterey Institute of International Studies, Pennsylvania State University, Rutgers University, Tufts University, The Rochester Institute of Technology, The University of Delaware, The University of Missouri at Columbia, The University of Montana, The University of North Alabama, Williamette University, and Yale University.

Themeluesi

